



This project is funded by the
European Union



EDUKIMI PËR MEDIAN DHE INFORMIMIN

Kurrikula për mësuesit

(Draft)

Ky aktivitet organizohet në kuadrin e projektit “Ndërtimi i Besimit në Media në Europën Juglindore dhe në Turqi, Faza e Dytë”, financuar nga BE dhe UNESCO.

Tabela e përmbajtjes:

I.	Rëndësia e edukimit për median dhe informimin.....	3
II.	Kurrikula dhe kuadri i kompetencës.....	4
III.	Përmbajtja e konceptit të edukimit për median dhe informimin.....	6
IV.	përfitimet dhe kërkesat e edukimit për median dhe informimin.....	8
V.	Tematikat kryesore të EMI-t për mësuesit.....	9
VI.	Korniza kurikulare	10
VII.	Korniza kurikulare e EMI-t për mësuesit	11
VIII.	Politika dhe vizioni.....	12
IX.	Rëndësia e njohjes së EMI-t për dialogun demokratik dhe pjesëmarrjen shoqërore.....	13
X.	Merësimi i medias dhe informacionit.....	15
XI.	Prodhimi dhe përdorimi i medias dhe informacionit.....	16
XII.	Kompetencat themelore të mësuesve.....	17
XIII.	Kompetencat kryesore të edukimit për median dhe informimin dhe rezultatet e pritshme.....	20
XIV.	Pedagogjitë për të mësuarit dhe mësimdhënien e edukimit për median dhe informimin- përdorimi i kurrikulës.....	25

I. RËNDËSIA E EDUKIMIT PËR MEDIAN DHE INFORMIMIN

Ne jetojmë në një botë, në të cilën cilësia e informacionit që marrin, në një shkallë të madhe, përcaktohet nga zgjedhjet dhe veprimet tona që i pasojnë ato, duke përfshirë zotësinë tonë për të gëzuar liritë themelore dhe aftësinë për vetvendosje dhe zhvillim. Si rrjedhojë e përmirësimeve teknologjike në fushën e telekomunikacionit është rritur edhe numri i ofruesve të medias dhe të informacioneve të tjera, përmes të cilëve është zgjeruar sasia e informacionit dhe e njohurive që mbërrin tek qytetarët dhe përçohet prej tyre. Sfida e qytetarëve për të vlerësuar rëndësinë dhe besueshmërinë e këtij informacioni, në zbatim të të drejtës së tyre për lirinë e shprehjes dhe të informimit, burojnë pikërisht nga kjo dukuri. Në këtë kontekst, nevoja për edukimin për median dhe informimin duhet të vlerësohet si zgjerim i lëvizjes për edukimin qytetar, në të cilën mësuesit janë agjentët kryesorë të ndryshimit.

Kurrikula e edukimit për median dhe informimin për mësuesit është një burim i rëndësishëm për të vazhduar punën për arritjen e objektivave të këtij edukimi për dy arsye kryesore. Së pari, kjo kurrikul orientohet nga e ardhmja, duke u bazuar në prirjet e të sotmes të konvergimit në një platformë të vetme të radios, televizionit, internetit, gazetave, librave, arkivave digjitale dhe bibliotekave, duke bërë që, për herë të parë, edukimi për median dhe informimin të kuptohet dhe të paraqitet në mënyrë tërësore e shumëdimensionale. Së dyti, kjo kurrikul, në mënyrë të veçantë, është hartuar duke pasur në mendje mësuesin dhe për t'u integruar në sistemin e zyrtar të formimit të mësuesit. Në këtë dimension, kjo kurrikul shërben edhe si një proces katalizator që synon aftësimin e milionave të rinjve.

UNESCO ka bërë të pamundurën për të siguruar qasjen sistematike dhe tërësore për përgatitjen e kësaj kurrikule për mësuesit, përmes skicimit, rishikimit, miratimit të vlefshmërisë së saj nga një numër i madh ekspertësh të fushave të ndryshme si media, informimi, TIK, arsimit dhe zhvillimi i kurrikulës. Kjo punë, që i ka fillimet e saj në vitin 2008 përfshin: organizimin e takimit të një grupi ekspertësh ndërkombëtarë që shërbeu si grup këshillimor për strategjinë e përgatitjes së kurrikulës; përcaktimin e burimeve globale të trajnimit për edukimin për median dhe informimin; krijimin e katër grupeve me ekspertë që përgatitën draftin e kurrikulës; organizimin e një takimi të dytë me grupin e ekspertëve ndërkombëtarë për të vlerësuar draftin, një numër testimesh përmes seminareve trajnuese e konsultime në Afrikën Jugore, në Amerikën Latine dhe Karaibe si dhe në Azinë Jugore, të cilat çuan në përgatitjen e një drafti të dytë si dhe një ndërhyrje të fundit për redaktimin e përmbajtjes dhe për korrektimin gjuhësor.

Përgatitja e kësaj kurrikule për mësuesit përfaqëson njërin prej përbërësve të një strategjie të plotë për të krijuar shoqëri të arsimuara në fushën e medias dhe të informimit dhe për të nxitur bashkëpunimin ndërkombëtar. Të tjera produkte të rëndësishme në këtë fushë janë: përgatitja e një *“Kornize ndërkombëtare për treguesit e edukimit për median dhe informimin”*, krijimi i një *“Rrjeti universitar për edukimin për median dhe informimin”*, përgatitja e *“Udhëzimeve për përgatitjen e politikave kombëtare për edukimin për median*

dhe informimin” dhe krijimi i një “Qendre ndërkombëtare për edukimin për median dhe informimin”, në bashkëpunim me Aleancën e Qytetërimeve të Kombeve të Bashkuara”.

UNESCO është e kënaqur me interesin ndërkombëtar për Kurrikulën e edukimit për median dhe informimin për mësuesit. Ajo ka besimin se ky interes do të përkthehet në rezultate pozitive në Fazën e dytë të nismës që ka si objektiv përshtatjen dhe pilotimin e kurrikulës në institucionet e trajnimit të mësuesve në të gjitha rajonet e botës.

Po kështu, UNESCO ka bindjen që kjo kurrikul do të kontribuojë në përmirësime në të gjitha nivelet e arsimit dhe falendero të gjithë partnerët që ndihmuan në këtë proces.

II. KURRIKULA DHE KUADRI I KOMPETENCËS

Hyrje

Neni 19 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut shpall se “ Çdo individ ka të drejtën e lirisë së opinionit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë për të pasur opinione pa ndërhyrje dhe për të kërkuar, për të marrë dhe për të përçuar informacion dhe ide përmes çdo lloji medie dhe pavarësisht nga kufijtë. Edukimi për median dhe informimin i pajis qytetarët me kompetencat e nevojshme për të kërkuar dhe për të gëzuar të gjithë përfitimet e të drejtave të tij themelore.

Deklarata e Grunvald e vitit 1982 përforcon realizimin e kësaj të drejte, e cila pranon nevojën për sisteme politike dhe arsimore që nxisin dhe zhvillojnë të kuptuarit kritik të dukurisë së komunikimit dhe pjesëmarrjen e tyre në median (e re dhe të vjetër). Kjo mbështetet më tej nga Deklarata e Aleksandrisë e vitit 2005, e cila e vendos edukimin për median dhe informimin në qendër të të mësuarit gjatë gjithë jetës. Ajo pranon se edukimi për median dhe informimin fuqizon njerëzit, në të gjitha rrugëtimet e jetës, për të kërkuar, për të vlerësuar, për të përdorur dhe për të krijuar informacion në mënyrë të efektshme për të përmbushur synimet e tyre personale, shoqërore, profesionale dhe arsimore. Kjo është një e drejtë themelore në një botë digjitale dhe nxit përfshirjen sociale të të gjithë vendeve.

Media dhe ofruesit e tjerë të informacionit si bibliotekat, arkivat dhe interneti pranohen sot gjerësisht si mjete thelbësore për të ndihmuar qytetarët në marrjen e vendimeve të mirëmenduara mbi bazën e informacionit të plotë të çështjes për të cilën do të marrin vendim. Ato janë edhe mjete me anë të të cilave shoqëria mëson për veten, mbajnë gjallë diskutimet publike dhe krijojnë ndjenjën e të qenit pjesë e një komuniteti. Kanalet e medias dhe të informimit kanë rol të madh në të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe, për këtë arsye, qytetarët kanë nevojë për disa njohuri bazë për mënyrën e funksionimit të medias dhe të ofruesve të tjerë të informacionit dhe të përdorimit të tyre. Qëllimi i edukimit për median dhe informimin është të përçojë këto njohuri tek përdoruesit.

Edukimi për median dhe informimin përfshin një grup njohurish për (a) funksionimin e medias, të librarive, të arkivave dhe të ofruesve të tjerë të informacionit në shoqëritë demokratike, (b) kushtet që mundësojnë realizimin me sukses të këtyre funksioneve dhe (c) për mënyrën e vlerësimit të cilësisë së realizimit të tyre përmes vlerësimit të përmbajtjes dhe të shërbimeve që ato ofrojnë. Si rrjedhojë, këto njohuri duhet t'u shërbejnë përdoruesve të përdorin në mënyrë të qëllimshme kanalet e medias dhe të informimit. Kompetencat e fituara përmes edukimit për median dhe informimin mund të pajisin qytetarët me aftësitë e të menduarit kritik, duke u dhënë atyre mundësinë të kërkojnë nga media dhe ofruesit e tjerë të informacionit cilësi të lartë shërbimesh. Së bashku, ato formojnë një mjedis të aftë, në të cilin media dhe ofruesit e tjerë të informacionit të mund të ofrojnë shërbime cilësore.

Për arsye të pranishme të kudondodhur të dimensionit gjeografik dhe kulturor, media e informimit merr sot një vend më të dukshëm në këtë kurrikul dhe kuadër kompetencash në krahasim me mediet e tjera. Ato përfshijnë një sistem shumëplanësh të rrymave të informimit. Duke qenë një institucion, media e informimit ka funksione të veçanta, të cilat priten të përmbushen në shoqëritë demokratike. Si rregull, për shkak të karakterit të saj universal dhe të kufizimeve në fushën e frekuencave (scarcity of spectrum), media elektronike, ndryshe nga ajo e shkruar, është rregulluar për të siguruar baraspeshën e kërkuar. Sistemet e vetrregullimit në median e informimit janë zhvilluar si një rrugë alternative për të siguruar përgjegjshmërinë ndaj interesit të publikut të gjerë.

Sistemi i vetrregullimit ngrihet mbi vlera dhe parime të veçanta etike. Si i tillë, publiku ka pritshmëritë e tij të veçanta nga media e informimi, duke e ekspozuar atë përballë kritikizmit në rastet kur nuk përmbush pritshmëritë e tij. Në këtë këndvështrim, ky kuadër ofron një lente përmes të cilës media e informimi mund të vlerësohet në lidhje me funksionet e tyre, të kushteve në të cilat ato i kryen këto funksione dhe të rrugëve në të cilat produkti i tyre përvetësohet nga publiku.

Zhvillimi i edukimit për median dhe informimin me nxënësit, kërkon edhe mësues të kualifikuar në këtë fushë. Vënia e theksit që në fillim tek mësuesit është çelësi strategjik për arritje të shumëfishta: nga mësuesit e kualifikuar tek nxënësit dhe më tej tek shoqëria në përgjithësi. Mësues të arsimuar në fushën e medias dhe të informimit do të kenë mundësi më të mëdha për të fuqizuar nxënësit në përpjekjet e tyre për të mësuar si të mësojnë, të mësojnë në mënyrë të pavarur dhe të mësojnë gjatë gjithë jetës. Duke edukuar nxënësit në fushën e medias dhe informimit, mësuesit do të përmbushin, së pari, rolin e tyre mbrojtës dhe mbështetës të qytetarisë së informuar dhe të arsyeshme dhe, së dyti, ata do t'i përgjigjeshin ndryshimeve në rolin e tyre si edukatorë, ndërkohë

që mësimdhënia zhvendoset nga ajo me në qendër mësuesin, në mësimdhënien me në qendër nxënësin.

Mësuesit mund të përqafojnë kurrikulën e edukimit për median dhe informimin nëse ajo lidhet edhe me strategjitë pedagogjike që përmirësojnë mënyrën e mësimdhënies së lëndëve në shkollë. Në fakt, dy ndër synimet më të rëndësishme e kurrikulës së edukimit për median dhe informimin dhe të kuadrit të kompetencave janë nxitja e ndryshimeve në sektorin e arsimit dhe ndikimi i saj në zhvillimin profesional të mësuesit.

III. PËRMBAJTJA E KONCEPTIT TË EDUKIMIT PËR MEDIAN DHE INFORMIMIN

Kurrikula e Edukimit për median dhe informimin dhe kuadri i kompetencave i UNESCO, përfsnin në një të vetme dhe harmonizon dy fusha që dallohen nga njëra tjetra: edukimi për median dhe edukimi për informimin me emrin edukimi për median dhe informimin. Ky konceptim shkon përtej kuptimit etimologjik të termave të veçantë, drejt një koncepti të unifikuar të edukimit për median dhe informimin dhe të synimeve dhe objektivave të tij.

Reultatet kryesore të pritshme

Edukimi për informimin:

Përcakton dhe përshkruan nevojat e informimit	Gjen dhe përdor informacionin	Vlerëson informacionin	Organizon informacionin	Përdor informacionin në mënyrë etike	Komunikon informacionin	Përdor aftësitë e TIK për përpunimin e informacionit
---	-------------------------------	------------------------	-------------------------	--------------------------------------	-------------------------	--

Edukimi për median

Përshkruan rolin dhe funksionet e media në shoqëritë demokratike	Përshkruan kushtet e nevojshme për përmbushjen e funksioneve të medias	Vlerëson në mënyrë kritike përmbajtjen e medias në dritën e funksioneve të saj	Përdor median për shprehjen e vetes dhe për pjesëmarrje demokratike	Aftësitë e vlerësimit (përfshi ato të TIK) që janë të nevojshme për të prodhuar përmbajtje që buron nga përdoruesi
--	--	--	---	--

Nga njëra anë, edukimi për informimin vë theksin në rëndësinë e përdorimit të informacionit dhe të vlerësimit e të përdorimit të tij. Nga ana tjetër, edukimi për median vë theksin në zotësinë për të kuptuar funksionet e medias, për të vlerësuar si përmbushen këto funksione dhe për të përdorur median në mënyrë të arsyeshme për të shprehur veten. Kurrikula e Edukimit për median dhe informimin dhe kuadri i kompetencave për mësuesit harmonizon të dy idetë. Përcaktimet ose konceptimet e ndryshme për edukimin për median dhe informimin e hedhin vështrimin nga kompetencat, që theksojnë zhvillimin e aftësive që bazohen tek

kërkimi dhe të aftësive për t'u përfshirë në mënyrë të qëllimshme në kanalet e medias dhe të informimit, pavarësisht nga format dhe teknologjitë që përdorin.

Sot ekzistojnë dy shkolla kryesore në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet këtyre fushave, të cilat shkojnë drejt një pike të vetme: edukimi për median dhe edukimi për informimin. Për disa, edukimi për informimin shihet si fusha më e gjerë e studimit, kurse edukimi për median shihet si pjesë e saj. Për të tjerë, edukimi për informimin është thjesht një pjesë e edukimit për median që, në këtë këndvështrim, shihet në kuptimin e gjerë.

Megjithatë, një grup ndërkombëtar, i mbledhur nga UNESCO, ka vënë në dukje jo vetëm dallimet, por edhe lidhjet ndërmjet medias dhe ofruesve të tjerë të informacionit. Më poshtë janë disa nga konceptet që janë përdur nga aktorë të ndryshëm në botë në lidhje me këtë marrëdhënie:

- Edukimi për median
- Edukimi për informimin
- Edukimi për lirinë e shprehjes dhe të informimit
- Edukimi për bibliotekar
- Edukimi për lajmet
- Edukimi për përdorimin e kompjuterit
- Edukimi për përdorimin e internetit
- Edukimi për botën digjitale
- Edukimi për fushën e filmografisë
- Edukimi për botën e lojërave
- Edukimi për botën e televizionit dhe të reklamës

Marrëdhëniet ndërmjet këtyre koncepteve janë të dukshme. Në këtë dokument kurrikular nuk do të merremi me të gjithë larminë e këtyre marrëdhënieve. Për t'u nënvizuar këtu është fakti që sa më shumë njohuri të kenë mësuesit në fushën e edukimit për median dhe informimin, aq më shumë ata do të ndeshen me këto koncepte dhe aq më shumë do të mësohen me to. Shumë prej këtyre koncepteve vazhdojnë të jenë objekt debati të gjallë dhe përdoren në mënyrë të ndryshme në varësi të kontekstit profesional ose kulturor të komunitetit të atyre që i përdorin. Shumë organizata në botë e përdorin termin edukim për median, që në disa raste pranohet se përfshin edhe edukimin për informimin. Përdorimi nga UNESCO i termit Edukimi për median dhe informimin kërkon të harmonizojë konceptet e ndryshme në dritën e platformave që i ofrojnë ato.

Modeli i Kurrikulës së edukimit për median dhe informimin dhe kuadri i kompetencave për mësuesit synon t'u ofrojë sistemeve arsimore të formimit të mësuesve, në vendet e zhvilluara dhe në zhvillim, një kuadër për të ndërtuar programe për formimin e mësuesve të arsimuar në fushën e medias dhe të informimit.

Unesco kërkon nga mësuesit që do të vlerësojnë kuadrin dhe të pranojnë sfidën e pjesëmarrjes në një proces kolektiv të modelimit dhe të pasurimit të kurrikulës si një dokument i gjallë. Për këtë arsye, kurrikula për përqendrohet vetën në kompetencat themelore dhe aftësitë që mund të integrohen në sistemin ekzistues të trajnimit të mësuesve pa i rënduar ata.

IV. PËRFITIMET DHE KËRKESAT E EDUKIMIT PËR MEDIAN dhe INFORMIMIN

Edukimi për median dhe informimin zhvillon aftësitë e njerëzve për të gëzuar të drejtat e tyre themelore, në mënyrë të veçantë, siç shprehet edhe neni 19 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, që “Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe njoftimit të informacionit dhe ideve me çfarëdo mjeti qoftë, pa marrë parasysh kufijtë”

Përfitimet kryesore nga edukimi për median dhe informimin:

- Ai pajis mësuesit në procesin e mësimdhënies dhe të mësuarit me njohurit të rëka për të fuqizuar qytetarët e ardhshëm.
- Edukimi për median dhe informimin mundëson njohuri të rëndësishme për funksionet e medias dhe të kanaleve të informimit në shoqëritë demokratike, të kuptuarit e arsyeshëm të kushteve të nevojshme për përmbushjen e këtyre funksioneve në mënyrë të efektshme dhe aftësitë bazë të domosdoshme për të vlerësuar veprimtarinë e medias dhe të ofruesve të informimit në dritën e funksioneve të pritshme.
- Një shoqëri e arsimuar në fushën e medias dhe të informimit kultivon zhvillimin e një medie ta pavarur dhe pluraliste dhe të sistemeve të hapura të informimit.
- Për të gëzuar përfitimet e Edukimit për median dhe informimin është e nevojshme që:
- Edukimi për median dhe informimin të vlerësohet si një e tërë dhe tjetër përfshijë harmonizimin e kompetencave (njohuri, aftësi dhe qëndrime).
- Kurrikula e edukimit për median dhe informimin aftëson mësuesit në procesin e mësimdhënies së këtij edukimi tek nxënësit, për t'i pajisuar ata me mjetet thelbësore për të qenë edhe ata pjesë e medias dhe e kanaleve të informimit si qytetarë të pavarur dhe të arsyeshëm.
- Qytetarët duhet të kenë njohuri për vendndodhjen dhe konsumin e informacionit, si dhe për prodhimin e tij.
- Gratë, burrat dhe grupet e marginalizuara, siç janë njerëzit me aftësi të kufizuara, grupet e pakicave etj. duhet të kenë mundësi reale të përdorimit të informacionit dhe të njohurive në mënyrë të barabartë me të tjerët.
- Edukimi për median dhe informimin duhet të vlerësohet si një mjet thelbësor për të lehtësuar dialogun ndërkulturor, mirëkuptimin e ndërsjellë dhe të kuptuarit e kulturës së tjetrit.

V. TEMATIKAT KRYESORE TË EDUKIMIT PËR MEDIAN DHE INFORMIMIN PËR MËSUESIT

Kurrikula e edukimit për median dhe informimin dhe kuadri i kompetencave duhet të interpretohet në dritën e konteksteve të veçanta në të cilat do të përdoret. Në këtë kuptim, ajo është një mjet elastik që mund të përshtatet në kontekstet e vendeve të ndryshme. Në fakt, kuadri kurrikular shpjegon një strukturë për zhvillimin e një programi studimi *rreth* edukimit për median dhe informimin dhe përmes niveleve të ndryshme të përfshirjes në fushën e medias dhe në kanaleve të informimit. Kompetencat përcaktojnë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që pritet të zhvillojë kjo kurrikul.

Në përgjithësi, kurrikula e edukimit për median dhe informimin synon të ndihmojë mësuesit të eksplorojnë dhe të kuptojnë edukimin për median dhe informimin duke trajtuar çështje të tilla si:

- Funksionet e medias dhe të ofruesve të informimit, mënyrën e funksionimit dhe kushtet e nevojshme për kryerjen me efektshmëri të këtyre funksioneve.
- Si duhet të vlerësohet në mënyrë kritike informacioni i paraqitur, në kuadrin e konteksteve të veçanta dhe të gjera të prodhimit të tij.
- Konceptin e pavarësisë botuese dhe të gazetarisë si një ndër disiplinat e verifikimit.
- Mënyrën se si media dhe ofruesit e tjerë të informacionit mund të kontribuojnë në mënyrë të arsyeshme në nxitjen dhe zhvillimin e lirive themelore dhe të të mësuarit gjatë gjithë jetës, në mënyrë të veçantë të mënyrës si ato lidhen me *si* dhe *pse* të rinjtë e sigurojnë dhe e përdorin sot median dhe informacionin dhe si i përzgjedhin dhe i vlerësojnë ato.
- Etikën e medias dhe të informimit.
- Zotësitë, të drejtat dhe përgjegjësitë e individëve në lidhje me median dhe informimin.
- Standardet ndërkombëtare (Deklarata universale e të drejtave të njeriut), liria e informimit, garancitë kushtetuese për lirinë e shprehjes, kufizimet e nevojshme për të parandaluar shkeljet e të drejtave të njerëzve të tjerë (si fjalimet që përmbajnë urrejtje, shpifjet dhe jeta private).
- Pritshmëritë nga media dhe nga ofruesit e tjerë të informacionit (pluralizmi dhe diversiteti si një rregull).
- Burimet e informacionit dhe sistemet e ruajtjes dhe të organizimit.
- Proceset e sigurimit, të kërkimit dhe të përcaktimit të nevojave të informimit.
- Vendndodhjen dhe mjetet e rrimarjes.
- Mënyrën e të kuptuarit, të organizimit dhe të vlerësimit të informacionit, duke përfshirë edhe burimet e besueshme.
- Krijimin dhe paraqitjen e informacionit në formate të larmishme.
- Mirëmbajtjen, magazinimin, ripërdorimin, regjistrimin, arkivimi dhe paraqitjen e informacionit në formate të përdorshme.

- Përdorimin e informacionit për zgjidhjen e problemeve ose për të marrë vendime për çështje të jetës personale, ekonomike, sociale e politike. Megjithëse është shumë e rëndësishme, kjo çështje përfaqëson një zgjatim të edukimit për median dhe informimin që shkon përtej kornizave të kësaj kurrikule.

VI. KORNIZA KURRIKULARE

Duke u bazuar në rekomandimet e grupit të ekspertëve të UNESCO-s për edukimin për median dhe informimin dhe në modulet e zhvilluara për të shoqëruar kornizën kurrikulare, u skicuan edhe tri fusha kryesore tematikash të ndërlidhura me njëra-tjetrën, si fusha të gjera kurrikulare në të cilat përfshihet edhe kurrikula e edukimit për median dhe informimin për mësuesit. Ato janë:

- 1. Njohja dhe të kuptuarit e medias dhe informimit për dialogun demokratik dhe pjesëmarrjen shoqërore.**
- 2. Vlerësimi i teksteve të medias dhe të burimeve të informacionit.**
- 3. Prodhimi dhe përdorimi i medias dhe informacionit.**

Këto tre fusha u lidhën me gjashtë fusha kryesore të arsimit të përgjithshëm dhe të zhvillimit të mësuesve për të përshkruar marrëdhënien e tyre progresive dhe për të krijuar një kornizë kurrikulare për Kornizën kurrikulare të edukimit për median dhe informimin për mësuesit, të përshkruar në tabelë më poshtë

Korniza kurrikulare e edukimit për median dhe informimin dhe modulet kurrikulare shoqëruese nuk janë të deturueshme por shërbejnë për të lehtësuar përshatjen e tyre në strategjitë kombëtare, rajonale dhe globale.

Ato duhet të jenë fleksibël për t'u përshtatur në sistemet e ndryshme arsimore dhe institucionale dhe sipas nevojave vendore. Megjithatë, UNESCO sugjeron që, në çdo rast, paraqitja e edukimit për median dhe informimin tek mësuesit është e nevojshme të përmbajë elemente që theksojnë liritë themelore të shpallura në nenin 19 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut. Cilado qoftë forma e përshtatjes, edukimi për median dhe informimin duhet të synojë të ndihmojë mësuesit të kuptojnë rëndësinë e lirive themelore dhe të të drejtave, si pjesë e qënësishme e edukimit qytetar, së pari në mjedisin e klasës dhe, më tej, në ata vendor e global.

Kurrikula e edukimit për median lidhet me mjediset e shkruara dhe ato audiovizuale, ku përfshihen gazetat, librat, media elektronike si radio dhe televizioni dhe media e informimit online si dhe ofrues të tjerë të informacionit. Në këtë mënyrë, trajnimi i mësuesve të edukimit për median dhe informimin nuk duhet të lidhet vetëm me ata që kanë mundësi të përdorin teknologjitë e përparuara. Ai mund të zbatohet edhe kontekste ku prania e teknologjive të përparuara është e kufizuar.

VII. KORNIZA KURRIKULARE E EDUKIMIT PËR MEDIAN DHE INFORMIMIN PËR MËSUESIT

Dimensionet e kurrikulës

Fushat kryesore kurrikulare	Njohuri për median dhe informimin për dialogun demokratike	Vlerësimi i medias dhe informimit	Prodhimi dhe përdorimi i medias dhe informacionit
Politika dhe vizioni	Përgatitja e mësuesve të arsimuar në fushën e medias dhe informimit	Përgatitja e nxënësve të arsimuar në fushën e medias dhe informimit	Kultivimi i një shoqërie të arsimuar në fushën e medias dhe informimit
Kurrikula dhe vlerësimi	Njohuri për median, bibliotekat, arkivat dhe ofruesit e tjerë të informacionit, për funksionet e tyre dhe kushtet e nevojshme për kryerjen e këtyre funksioneve.	Të kuptuarit e kriterëve për vlerësimin e teksteve të medias dhe të burimeve të informacionit.	Aftësitë për të eksploruar mënyrën si prodhohet informacioni dhe tekstet e medias, kontestin social dhe kulturor të prodhimit të informacionit dhe medias
Pedagogjia	Integrimi i medias dhe informimit në diskutimet në klasë	Vlerësimi i përmbajtjes së medias dhe të ofruesve të tjerë të informacionit për të zgjidhur problemet	Përmbajtje e përzgjedhur nga përdoruesit dhe përdorimi i saj për të mësuarit dhe mësimdhënien
Media dhe informimi	Media e shkruar – gazetat dhe revistat; ofruesit e informacionit – bibliotekat, arkivat, muzetë, librat, gazetat etj.	Media elektronike –radio dhe TV	Media e re – interneti, rrjetet shoqërore, platformat ofruese (kompjuterat, telefonia celulare etj.)
Organizimi dhe administrimi	Njohja e organizimit të klasës	Bashkëpunimi përmes edukimit për median dhe informimin	Zbatimi i edukimit për median dhe informimin për të mësuarit gjatë gjithë jetës
Zhvillimi profesional i mësuesve	Njohja e edukimit për median dhe informimin për edukimin qytetar, pjesëmarrje në komunitetin profesional dhe qeverisjen e shoqërive të tyre.	Vlerësimi dhe menaxhimi i burimeve të medias dhe të informimit për të mësuarit profesional	Lidershipi dhe qytetari model; mbrojtja e zhvillimit dhe përdorimit të edukimit për median dhe informimin për zhvillimin e mësuesve dhe nxënësve.

VIII. POLITIKA DHE VIZIONI

Për të siguruar përfshirjen sistematike dhe progresive të edukimit për median dhe informimin në të gjitha nivelet e arsimit është e nevojshme të ndërtohet një politikë kombëtare për këtë qëllim e cila të përmbajë edhe vizionin për të ardhmen.

Pikë nisje në këtë drejtim duhet të shërbejë njohja e politikave kombëtare arsimore, ligjet që mundësojnë lirinë e shprehjes dhe të informimit dhe instrumente të tjerë ndërkombëtarë për lirinë dhe ndërthurjen e tyre me politikat e edukimit për median dhe informimin.

Atje ku mungon politikat për edukimin për median dhe informimin, duhet të shtrohet çështja: *Cili duhet të jetë roli që mund të luajnë mësuesit në mënyrë që të mbështeten këto politika?*

Nëse ato ekzistojnë atëhere duhet të shtrohet çështja e cilësisë ose të përditësimit të shkallës së përditësimit të tyre. *Në çfarë shkallë ato pasqyrojnë standardet ndërkombëtare dhe praktikrat më të mira? Si mund të përmirësohen?*

Në këtë mënyrë, një aspekt kyç i kurrikulës së edukimit për median dhe informimin do të ishte diskutimi për politikën dhe vizionin e edukimit për median dhe informimin dhe lidhjet e tyre me arsimin e përgjithshëm dhe formimin e mësuesve në mënyrë të veçantë. Ky diskutim duhet të çojë në një analizë të politikës dhe të vizionit dhe të lidhjes së tyre me përgatitjen e mësuesve dhe nxënësve të arsimuar në fushën e edukimit për median dhe informimin. Në fund, ai duhet të tërheqë vëmendjen për rolin e mësuesve në kultivimin e shoqërive të arsimuara në këtë drejtim.

IX. RËNDËSIA E NJOHJES SË MEDIAS DHE INFORMIMIT PËR DIALOGUN DEMOKRATIK DHE PJESËMARRJEN SHOQËRORE

Objektivi i kësaj fushe të gjerë tematike është të zhvillojë të kuptuarit kritik të mënyrës si media dhe informimi mund të zhvillojnë aftësinë e mësuesve, nxënësve dhe qytetarëve në përgjithësi për t'u përfshirë në botën e medias dhe të përdorin bibliotekat, arkivat dhe ofruesit e tjerë të informacionit si mjete për lirënë e shprehjes, të pluralizmit, të dialogut ndërkulturor dhe tolerancës dhe si kontribues në debatin demokratik dhe qeverisjen e mirë. Tabela më poshtë përshkruan këtë marrëdhënie. Kjo temë përfaqëson një larmi çështjesh që priten në lidhje me funksionet dhe rëndësinë e medias dhe të informimit në të cilat bëjnë pjesë:

- Kanalet ofruese përmes të cilave qytetarët mund të komunikojnë me njëri-tjetrin.
- Shpërndarja e historive, ideve dhe informacioneve.
- Korrigjimi i asimetrisë së informacionit ndërmjet qeverisësve dhe të qeverisurve dhe agjentëve privatë konkurrues.
- Lehtësimi i debateve ndërmjet aktorëve të ndryshëm socialë dhe nxitja e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve me mjete demokratike.
- Sigurimi i mjeteve përmes të cilave shoqëria mëson për vete dhe ndërton ndjenjën e komunitetit.
- Sigurimi i një mjeti për shprehjes kulturore dhe kohezionin social brenda dhe ndërmjet kombeve.
- Veprimi si mbikëqyrës i qeverisë në të gjitha format, duke nxitur transparencë në jetën publike dhe shqyrtimi publik i atyre me pushtet duke hedhur dritë mbi korrupsionin dhe veprimet e gabuara të korporatave.
- Të punuarit si mjet për rritjen e efektshmërisë ekonomike.
- Lehtësimi i proceseve demokratike dhe ndihma për të siguruar zgjedhje të lira dhe të ndershme.
- Veprimi si mbrojtës dhe aktor social në përmbushje në të drejtave të tij ndërkohë që respekton vlerat demokratike (p.sh. media e informacionit).
- Të shërbyerit si kujtesë kolektive e shoqërisë (p.sh. bibliotekat).
- Ruajtja e trashëgimisë kulturore
- Sigurimi i një hyrje për informacione
- Ndhimja për të lidhur pjesët digjitale përmes sigurimit të mundësive të publikut të gjerë për t'i përdorur ato.
- Vlerësimi i bibliotekave si agjenci të informimit dhe si qendra burimore për të mësuarit.
- Nxitja e përdorimit të të gjitha llojeve të burimeve të informacionit në biblioteka.
- Lehtësimi i mësimdhënies, të mësuarit dhe i të mësuarit për të mësuar (edukimi për informimin) përmes bibliotekave akademike
- Edukimi i përdoruesit të bibliotekës.

Shtyllat kryesore të qeverisjes së mirë –p.sh. transparenca, llogaridhënia dhe pjesëmarrja qytetare- janë të vështira për t'u arrirë pa medie të hapur dhe sisteme informimi. Këto


sisteme mund të shërbejnë për të nxitur një shoqëri qytetare aktive ose një kulturë qytetare. Këto funksione shërbim përfshijnë:

- Sigurimin e informacionit dhe të njohurive të kuptueshme të cilat janë në interesin e grupeve të ndryshme.
- Frymëzimi i besnikërisë dhe i përkushtimit të qendrueshëm ndaj vlerave dhe procedurave që mbështesin demokracinë dhe qeverisjen e mirë.

Kurikula e edukimit për median dhe informimin i pajis mësuesit me përballjet e nevojshme për të zhvilluar aftësitë për integrimin e edukimit për median dhe informimin në praktikën e klasës në mënyrë që u japin vlerë zërit të nxënësve dhe është i ndjeshëm ndaj përfaqësimit gjinor. Këtu, shtrohet çështja e përdorimit të medias dhe të burimeve të informacionit për të shprehur veten dhe për të shumëfishuar zërat individualë me qëllim që të zhvillohen idetë dhe këndvështrimet e ndryshme.

Ofruesit e medias dhe të informacionit kanë krijuar platforma për zgjerimin e pjesëmarrjes në të mësuarit profesional. Në disa vende kjo mund të jetë përdorur për të mësuarit e hapur dhe në distancë dhe për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të mësuesve. Kurrikula eksplorom si mediet e ndryshme dhe burimet e informacionit mund të përdoren për të rritur cilësinë e pjesëmarrjes së mësuesve në komunitetet e tyre profesionale. Mësuesit që punojnë në kontekste të ndryshme sociale dhe vende të ndryshme gjeografike mund të shkëmbejnë njohuritë dhe informacionin rreth të mësuarit dhe praktikës profesionale.

Edukimi për median dhe informimin dhe rëndësia e tij për demokracinë dhe qeverisjen e mirë



X. VLERËSIMI I MEDIAS DHE INFORMACIONIT

Zgjidhja e problemit dhe të menduarit kritik qëndrojnë në themel të të mësuarit të të gjitha lëndëve në shkollë si dhe në jetën e përditshme. Problemet krijojnë edhe shanset për vlerësimin kritik të teksteve të medias dhe të informacionit nga burime të ndryshme.

Një ndër objektivat e vlerësimit të medias dhe informacionit është të zhvillohet aftësia e mësuesve për të verësuar burimet e informacionit dhe për të vlerësuar informacionin duke u bazuar në funksionet e veçanta të shërbimit që, në përgjithësi priten nga media, bibliotekat, arkivat dhe nga ofrues të tjerë të informacionit.

Një tjetër objektiv është të pajisen mësuesit me njohuritë e veprimeve që mund të ndërmerren kiur këto sistem shmangen nga pritshmëritë e rolit të tyre. Mësuesit duhet të jenë në gjëndje të shqyrtojnë dhe të kuptojnë si prodhohet përmbajtja e medias dhe e informacioneve të tjera, si mund të vlerësohet informacioni që paraqesin këto sisteme dhe si mund të përdoren media dhe informacioni për qëllime të ndryshme.

Më tej, mësuesit duhet të jenë të aftë të eksplorojnë çështjet e paraqitjes në medie dhe sisteme të ndryshme informimi dhe të rrugëve në të cilat trajtohet diversiteti dhe pluralizmi në median lokale dhe globale.

Në fund, mësuesit duhet të zhvillojnë aftësinë për të vlerësuar mënyrën si nxënësit interpretojnë mesazhet e medias dhe të informimit që vijnë nga burime të ndryshme.

XI. PRODHIMI DHE PËRDORIMI I MEDIAS DHE INFORMACIONT

Kurrikula e edukimit për median dhe informimin i pajis mësuesit me kompetencat për t'u përfshirë në fushën e medias dhe të platformave të informimit, për të komunikur dhe për t'u shprehur në mënyrë të qëllimshme. Kjo nënkupton njohjen e etikës së medias dhe etikës së informimit të bazuar në standarde ndërkombëtare në të cilat përfshien kompetencat ndërkulturore. Zotësia për të përzgjedhur, për të përshtatur dhe për të zhvilluar materiale dhe mjete për edukimin për median dhe informimin, në përmbushje të një grupi objektivash mësimorë dhe të nevojave për të mësuarit e nxënësve, janë të nevojshme për mësuesit që të jenë në gjëndje të ndihmojnë nxënësit të përdorin këto mjete dhe burime në procesin e të mësuarit, veçanërisht në lidhje me kërkimin dhe prodhimin e medias.

Prodhimi dhe përdorimi i medias kërkon një pedagogji me në qendër nxënësin që nxit hetimin dhe të mendurit kritik nga nxënësit. Të mësuarit përmes të bërit është një aspekt i rëndësishëm i fitimit të njohurive në shekullin XXI. Prodhimi i medias u ofron nxënësve mundësinë e të mësuarit duke bërë, përmes të krijimit të teksteve dhe pamjeve në një mjedis pjesëmarrës. Mësuesit duhet të luajnë rol aktiv në këtë proces, me qëllim që nxënësit të mund të zhvillojë kompetencat për të mësuarit përmes pjesëmarrjes.

Përmbajtja e krijuar nga përdoruesi po bëhet një faktor tërheqës sundues si për median e re, ashtu edhe për ata tradicionale. Ndërveprimi me përdorues të tjerë të platformave të rrjeteve sociale po bëhet gjithnjë e më shumë arsyeja më e rëndësishme përse të rinjtë po përdorin internetin përmes platformave të ndryshme. Ky nuk është tipar vetëm i vendeve të zhvilluara: në Afrikë dhe Azi po rritet me shpejtësi numri i qytetarëve që po përdorin celularët për të marrë dhe për të dërguar mesazhe dhe për të marrë pjesë në debate për çështje sociale dhe politike që janë të rëndësishme për jetën e tyre.

Mësuesit që zotërojnë kompetencat dhe besimin e nevojshëm në prodhimin dhe përdorimin e medias dhe të informimit në mësimdhënie, bëhen modele të nxitjes dhe zhvillimit të edukimit për median dhe informimit në kurrikulën shkollore. Rritja e zotësisë së tyre në këtë fushë për funksione të ndryshme, i bën ata kampionë të këtij edukimi në shkollë dhe në shoqëri.

XII. KOMPETENCAT THEMELORE TË MËSUESVE

Tabela më poshtë përmban synime të gjera kurrikulare dhe aftësitë e mësuesve që duhet t'i përmbushin ato. Këto aftësi, pasqyrojnë kompetencat kryesore të cilat mësuesit duhet t'i fitojnë dhe t'i demonstrojnë për secilin prej elementëve të kuadrin të kurrikulës së edukimit për median dhe informimin. Tabela e dytë ofron rezultatet e pritshme që shërbejnë për të vlerësuar shkallën e zhvillimit të aftësive që lidheshin me fushat kurrikulare.

Synimet e kurrikulës dhe aftësitë e mësuesve në edukimin për median dhe informimin (EMI) të UNESCO-S

Fushat kurrikulare	Synimet e kurrikulës	Aftësitë e mësuesit
Politika dhe vizioni	Të bëjë mësuesit të vetëdijshëm për politikën dhe vizionin e nevojshëm për edukimin për median dhe informimin.	Mësuesit duhet të kuptojnë politikën e nevojshme për të nxitur dhe zhvilluar EMI dhe mënyrën e realizimit të tyre në arsim (dhe shoqëri). Ata duhet të kuptojnë si edukimi për median dhe informimin ndihmon në zhvillimin e aftësive për jetën dhe zhvillimin e mëtejshëm në kontekstin e edukimit qytetar.
Kurrikula dhe vlerësimi	Të theksojë rëndësinë e përdorimit burimeve të edukimit për median dhe informimin dhe të zbatimeve të tyre.	Mësuesit duhet të kuptojnë mënyrën se si mund të përdoret edukimi për median dhe informimin në kurrikulën shkollore. Ata duhet të jenë të aftë të vlerësojnë tekstet e medias dhe burimet e informacionit në mënyrë kritike, në dritën e funksioneve që priten të përmbushin media e re dhe ofruesit e tjerë të informacionit e të përzgjedhë për këtë qëllim një larmi të madhe materialeve nga media dhe burime informacioni. Ata duhet të kenë aftësinë për të vlerësuar sa nxënësit kuptojnë edukimin për median dhe informimin
Edukimi për median dhe informimin	Të rritë njohuritë për larinë e medieve dhe të ofruesve të tjerë të informacionit si bibliotekat, arkivat dhe interneti.	Mësuesit duhet të kuptojnë mënyrën e zhvillimit të medias dhe të burimeve të tjera të informimit në format në të cilat ekzistojnë sot. Ata duhet të zhvillojnë aftësitë për përdorimin e teknologjive ekzistuese për të arritur përdoruesit e ndryshëm të medias. Ata duhet të jenë të aftë të përdorin mediet e ndryshme dhe burimet e informacionit për të zhvilluar aftësitë e të menduarit kritik dhe të zgjidhjes së problemit dhe t'i shtrijë këto deri tek nxënësit.
Organizimi dhe administrimi	Të rritë zotësinë e mësuesve për të organizuar hapësirën e klasës për pjesëmarrje aktive në procesin e të mësuarit dhe të mësimdhënies dhe për të bërë edukimin për median dhe	Mësuesit e edukimit për median dhe informimin duhet të kuptojnë organizimin e klasës dhe të jenë të aftë të krijojnë kushtet e të mësuarit dhe të mësimdhënies për të rritur shkallën e përdorimit të medieve të ndryshme

	informimin pjesë të qënësishme të punës për arritjen e këtij qëllimi.	dhe të ofruesve të tjerë të informacionit për edukimin për qytetari dhe për të mësuarit gjatë gjithë jetës, duke përfshirë aftësitë për organizimin e të mësuarit me qëllim që të krijohet një klasë në të cilën respektohen pikëpamjet dhe këndvështrimet e ndryshme, pavarësisht nga prejardhja dhe gjinia.
Pedagogjia	Të prodhojë ndryshime në praktikat pedagogjike të mësuesve, të nevojshme për mësimdhënien e edukimit për median dhe informimin	Mësuesit e edukimit për median dhe informimin duhet të fitojnë aftësitë pedagogjike të nevojshme për të mësuarit dhe mësimdhënien e edukimit për median dhe informimin. Ata duhet të jenë të aftë për mësimdhënien e edukimit për median dhe informimin në këndvështrimin e qeverisjes së mirë dhe të dialogut ndërkulturor. Ata duhet të fitojnë njohuri për ndërveprimet dhe sjelljen e nxënësve me median, si hapi i parë mbështetës i të mësuarit në fushën e edukimit për median dhe informimin. Ata duhet të kuptojnë konceptet themelore, mjetet e kërkimit dhe strukturat e disiplinës së edukimit për median dhe informimin për të krijuar përvojat e të mësuarit që i bëjnë ato të rëndësishme për nxënësit dhe i përgatisin ata për rolin e tyre si qytetarë.
Zhvillimi profesional i mësuesve	Të zhvillojë një arsim për mësuesit që përqendrohet në zbatimin e medias dhe të burimeve të informacionit për të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe zhvillimin profesional	Mësuesit duhet të kenë aftësitë e nevojshme për të përdorur median dhe teknologjinë për të siguruar informacion dhe për të fituar njohuri lëndore dhe pedagogjike me qëllim që të mbështesin edhe zhvillimin e tyre profesional.

XIII. KOMPETENCAT KRYESORE TË EDUKIMIT PËR MEDIAN DHE INFORMIMIN DHE REZULTATET E PRITSHME

Lista e mëposhte e kompetencave përmban njpohuritë dhe aftësitë që duhet të fitojnë mësuesit për të mësuarit dhe mësime të edukimit për median dhe informimin.

Kompetenca 1

Të kuptuarit e rolit të medias dhe të informacionit në demokraci

Edukimi për median dhe informimin e ndihmon mësuesin të njohë dhe të kuptojë funksionet e medias dhe të ofruesve të tjerë të informacionit dhe rëndësinë e tyre për qytetarinë dhe vendimmarrjen e mirinformuar

Rezultatet e pritshme

Në lidhje me këtë kompetencë, mësuesi duhet të jetë i aftë:

- Të identifikojë, të përshkruajë dhe të vlerësojë funksionet publike të medias dhe të ofruesve të tjerë të informacionit në shoqëritë demokratike.
- Të analizojë konceptet kryesore të tilla si liria e shprehjes, e drejta e informimit dhe e lirive themelore të pasqyruara në nenin 19 të Deklaratës së Përgjithshme të të Drejtave të Njeriut.
- Të përshkruajë dhe të interpretojë marrëdhëniet ndërmjet edukimit për median dhe informimin, qytetarisë dhe demokracisë.
- Të përshkruajë pluralizmin e medias, median dhe ofruesit e tjerë të informacionit si platforma të dialogut ndërkulturor dhe të argumentojë rëndësinë e tyre.
- Të përshkruajë pavarësinë botuese.
- Të shpjegojë gazetarinë si një disiplinë e verifikimit brenda kufijve të shërbimit ndaj publikut.
- Të përshkruajë etikën e medias dhe të informimit dhe të jetë i aftë të identifikojë rastet e shkeljes së saj.

Kompetenca 2

Të kuptuarit e përmbajtjes së medias dhe të përdorimit të saj

Mësuesi i Edukimit për median dhe informimin do të jetë i aftë të demonstrojë njohuritë dhe të kuptuarit e mënyrës se si njerëzit përdorin median në jetën e tyre personale dhe publike, e marrëdhënieve ndërmjet qytetarëve dhe përmbajtjes së medias si dhe të përdorimit të medias për qëllime të ndryshme.

Rezultatet e pritshme

Në lidhje me këtë kompetencë, mësuesi duhet të jetë i aftë:

- Të interpretojë dhe të bëjë lidhjen ndërmjet teksteve të medias, kontekstit dhe vlerave të projektuara nga media.
- Të përdorë strategji për të analizuar stereotipat në median (p.sh. të njohë stereotipata që u shërbejnë disa grupeve të caktuara në shoqëri në kurriz të grupeve të tjerë; të identifikojë teknikat e përdorura në median pamore që përjetësojnë këto stereotipa.
- Të identifikojë, të analizojë dhe të kritikojë larmi teknikash të përdorura në reklama që janë kundër standardeve dhe kodeve ndërkombëtare të praktikës.
- Të eksplorojë përfaqësimet, keqinterpretimet dhe mungesën e përfaqësimit në media dhe tekste informuese.
- Të përshkruajë karakteristikat dhe rëndësinë e ofruesve të shërbimit të informimit publik

Kompetenca 3:

Sigurimi me cilësi dhe rendiment i informacionit

Mësuesi i edukimit për median dhe informimin do të jetë i aftë të përcaktojë tipin e informacionit të nevojshme për një detyrë të caktuar dhe të sigurojë informacioni në mënyrë cilësore dhe të efektshme

Rezultatet e pritshme

Në lidhje me këtë kompetencë, mësuesi duhet të jetë i aftë:

- Të përzgjedhë qasje cilësore dhe me rendiment për të siguruar informacionin që kërkon për qëllime hetimi ose informimi.
- Të identifikojë fjalët kyç dhe të tjerat që lidhen me to për të siguruar informacionin e nevojshëm.
- Të identifikojë larmi llojesh dhe formatesh të burimeve të ndryshme të informacionit.
- Të përshkruajë kriteret e përdorura për të marrë vendime dhe për të bërë zgjedhje në lidhje me informacionin.

Kompetenca 4

Vlerësimi kritik i informacionit dhe i burimeve të tij

Mësuesi i edukimit për median dhe informimin do të jetë i aftë të vlerësojë në mënyrë kritike informacionin dhe burimet e tij dhe të përfshijë informacionin e për zgjedhur për zgjidhjen e problemit dhe analizën e ideve.

Rezultatet e pritshme

Në lidhje me këtë kompetencë, mësuesi duhet të jetë i aftë:

- Të demonstrojë zotësinë për të shqyrtuar dhe për të krahasuar informacionin nga burime të ndryshme me qëllim që të vlerësojë besueshmërinë, vlefshmërinë, saktësinë, autoritetin, qëndrueshmërinë në kohë dhe njëanshmërinë.
- Të përdorë larmi kriteresh (p.sh. qartësia, saktësia, efektiviteti, njëanshmëria, rëndësia e fakteve) për të vlerësuar median informative (p.sh. faqet në internet, dokumentaret, reklamat, programet e reja).
- Të dallojë paragjykimin, mashtrimin ose manipulimin.
- Të dallojë kontekstet kulturore, sociale ose të tjera në kuadrin e të cilave është krijuar informacioni dhe është kuptuar ndikimi i kontekstit në interpretimin e tij.
- Të përshkruajë dhe të analizojë llojet e teknologjive që lidhen me median dhe të studiojë ndërveprimin e ideve.
- Të krahasojë njohuritë e reja dhe ato praprake për të përcaktuar vlerën e shtuar, kontradiktat ose karakteristikat e veçanta të informacionit.
- Të përcaktojë saktësinë e mundshme përmes dyshimit të të dhënave, kufizimet e mjeteve ose të strategjive me të cilat është mbledhur informacioni dhe drejtësinë e përfundimeve.
- Të përdorë strategji të ndryshme për të interpretuar tekstet e medias (p.sh. nxjerrjen e përfundimeve, përgjithësimet, sintetizimi i materialeve të para, referimi tek pamjet ose informacioni në median pamore për të mbështetur një pikëpamje, analiza e medias për të përcaktuar njëanshmëritë që qëndrojnë në themel të saj ose për të zbërthyer nëntekstin e saj).

Kompetenca 5

Zbatimi i formateve mediatike të reja dhe tradicionale

Mësuesi i edukimit për median dhe informimin do të jetë në gjëndje të përdorë teknologjinë digjitale, mjetet dhe rrjetet e komunikimit për mbledhjen e informacionit dhe për marrje vendimi

Rezultatet e pritshme

Në lidhje me këtë kompetencë, mësuesi duhet të jetë i aftë:

- Të përshkruajë bazat e teknologjisë digjitale, mjetet dhe rrjetet e komunikimit dhe përdorimi i tyre në kontekste të ndryshme për qëllime të ndryshme.
- Të përdorë larmi tekstesh mediatike për të shprehur idetë vetjake përmes formave të shumëfishta të medias (p.sh. shtypi tradicional, elektroni, digjital etj.).
- Të ndërmarë kërkime bazë për informacione online.
- Të shpjegojë qëllimet për të cilat rinia e përdor internetin.

KOMPETENCA 6:

Përcaktimi i kontekstit social dhe kulturor të përmbajtjes së medias

Mësuesi i edukimit për median dhe informimin do të jetë në gjëndje të demonstrojë njohuri dhe të kuptuarit e faktit që përmbajtja e medias është prodhuar brenda një konteksti social dhe kulturor.

Rezultatet e pritshme

Në lidhje me këtë kompetencë, mësuesi duhet të jetë i aftë:

- Të analizojë dhe të shpjegojë si mund të manipulohen rregullat dhe pritshmëritë që qeverisin llojet e medias për qëllime ose pasoja të veçanta.
- Të prodhojë tekste mediatike që paraqesin këndvështrime dhe përfaqësime të ndryshme.
- Të përshkruajë median dhe ofruesit e tjerë të informacionit si platforma të dialogut ndërkulturor.
- Të demonstrojë zotësinë për të vlerësuar në mënyrë kritike përmbajtjen e medias dhe të mesazheve të marra ose të krijuara prej tyre për qytetarinë demokratike dhe larminë kulturore.
- Të shpjegojë se si redaktimi modelon kuptimin në median pamore dhe në mesazhet e tyre (p.sh. pengesat ndaj këndvështrimeve alternative; këndvështrimet e filtruara ose të nënkuptuara; theksimi i ideve të veçanta etj.)

KOMPETENCA 7:

Zhvillimi i edukimit për median dhe informimin tek nxënësit dhe menaxhimi i kërkesave të kërkuara

Mësuesi i edukimit për median dhe informimin do të jetë në gjëndje të përdorë njohuritë dhe aftësitë e fituara përmes trajnimit për të zhvilluar edukimin për

median dhe informimin tek nxënësit dhe për të menaxhuar ndryshimet që lidhen me to në mjedisin e shkollës

Rezultatet e pritshme

Në lidhje me këtë kompetencë, mësuesi duhet të jetë i aftë:

- Të përshkruajë mënyrat e ndryshme të interpretimit dhe të zbatimit nga nxënësit të produkteve dhe të ngjarjeve të medias në jetën e tyre.
- Të përshkruajë dhe të përdorë larmi veprimtarisht mësimorë për të kultivuar tek nxënësit aftësitë në fushën e edukimit për median dhe informimin.
- Të tregojë zotësinë për të ndihmuar nxënësit që të përzgjedhin qasjen më të përshtatshme (p.sh. sistemet e sigurimit të informacionit) për të siguruar informacionin e nevojshëm.
- Të tregojë zotësinë e tij për të ndihmuar nxënësit në vlerësimin kritik të informacionit dhe të burimeve të tij , gjatë integrimit të njohurive të reja në sistemin e njohurive vetjake.
- Të përdorë njohuritë e teknikave të komunikimit të efektshëm me gojë, me shkrim dhe mediatik për të zhvilluar bashkëpunimin aktiv kërkues dhe komunikimin e lirë dhe të hapur ndërmjet nxënësve.
- Të përshkruajë dhe të përdorë strategjitë strategjitë e vlerësimit formal dhe joformal për të zhvilluar njohuritë dhe aftësitë e të lexuarit, e të parit dhe e të dëgjuarit kritik të nxënësve.
- Të përdorë mjetet e edukimit për median dhe informimin për të krijuar një mjedis të mësuarit më shumë pjesëmarrës për nxënësit.
- Të përdorë teknologjinë e vjetër e të re të medias për të krijuar lidhjet ndërmjet të mësuarit në shkollë dhe atij jashtë shkollës, veçanërisht për nxënësit që gjithnjë e më shumë ndihen të jashtë saj.
- Të përdorë teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit për të ndihmuar nxënësit të zbulojnë botën e TIK-ut dhe të burimet e medias që janë të pranishme dhe për t'i përdorur ato në procesin e të mësuarit të tyre.
- Të përdorë edukimin për median dhe informimin për të rritur pjesëmarrjen e tyre në procesin e të mësuarit.
- Të përdorë njohuritë dhe aftësitë e fituara përmes trajnimit për të zhvilluar aftësitë e nxënësve në përdorimin e medias dhe të burimeve të bibliotekës si mjete të kërkimit për të mësuar.
- Të përdorë njohuritë dhe aftësitë e fituara përmes trajnimit për të zhvilluar aftësitë e nxënësve në vlerësimin e medias dhe të informimit dhe në të kuptuarit e çështjeve etike që lidhen me edukimin për median dhe informimin.

XIV. PEDAGOGJITË PËR TË MËSUARIT DHE MËSIMDHËNIEN E EDUKIMIT PËR MEDIAN DHE INFORMIMIN- PËRDORIMI I KURRIKULËS

Qasjet e mëposhme pedagogjike qëndrojnë në themel të strategjive të përdorura në kurrikulën e edukimit për median dhe informimin:

1. Qasja e kërkimit të një çështjeje

Të mësuarit mbi bazën e kërkimit është një qasje që vendos nxënësin në qendër dhe që përqendrohet në një çështje që lidhet me edukimin për median dhe informimin në shoqërinë e sotme. Ajo përfshin shumë prej tipareve që lidhen me të mësuarit përmes kërkimit, zgjidhjes së problemit dhe vendimmarrjes, në të cilat nxënësi fiton njohuri dhe aftësi të reja përmes hapave të mëposhtëm të kërkimit: identifikimi i çështjes, pranimi i qëndrimeve dhe besimeve që qëndron në themel të saj; qartësimi i fakteve dhe parimeve që qëndrojnë pas saj, konteksti, organizimi dhe analiza e fakteve, interpretimi dhe zgjidhja e çështjes, ndërmarrja e veprimit, rishqyrtimi i pasojave dhe rezultateve nga secila fazë. Kjo metodë është e përshtatshme për të mësuarit e edukimit për median dhe informimin pasi u ofron nxënësve shanse për të eksploruar në thellësi çështjet që janë objekt studimi. Shembuj të kësaj metode janë: eksplorimi i mënyrës si paraqiten gjinia dhe raca përmes analizës së medias; eksplorimi i privatësisë dhe medias përmes analizës së dukumenteve parësore dhe dytësore; eksplorimi i cyber bulling-ut përmes kërkimeve etnografike.

2. Të mësuarit përmes problemit

Të mësuarit përmes problemit është një sistem të mësuarit dhe të zhvillimit të kurrikulës që njëherëzi zhvillon bazat dhe aftësitë e njohurive ndërlëndore, si dhe strategjitë e të menduarit kritik dhe të zgjidhjes së problemeve. Kjo metodë shumë e strukturuar ofron një mënyrë të mësuarit në bashkëpunim që synon të rritë njohuritë individuale dhe kolektive përmes përfshirjes së nxënësve në një kërkim kritik dhe të thelluar të problemeve të jetës reale. Objektivat e të mësuarit, pyetjet dhe metodat e kërkimit dhe rezultatet menaxhohen të gjitha nga nxënësit.

Një shembull i të mësuarit që bazohet tek problemi në edukimin për median dhe informimin përfshin ideimin e një fushate marketingu social të efektshëm për një grup të caktuar njerëzish

3. Kërkimi shkencor

Kërkimi shkencor përfshin një larmi teknikash që përdoren nga shkencëtarët për të eksploruar botën natyrore dhe për të propozuar shpjegimet që bazohen në faktet e gjetura. Shpesh herë, procesi i kërkimit paraqitet përmes një numri hapash të thjeshtuar të quajtur cikli i kërkimit, i cili

përfshin veprimtari të tilla si: ryerja e vëzhgimit, formulimi i pyetjeve, përcaktimi i njohurive paraprake, planifikimi i kërkimit, rishikimi i njohurive paraprake në dritën e fakteve eksperimentarë, përdorimi i mjeteve për të mbledhur, për të analizuar dhe për të interpretuar të dhënat, propozimi i shpjegimeve dhe komunikimi i rezultateve. Kjo metodë mund të përshtatet edhe për të mësuarit e edukimit për median dhe informimin.

Një ndër shembujt e kësaj metode është hetimi i ndikimit të dhunës së medias, hetimi i rolit të komuniteteve online.

4. Studimi i rastit

Metoda e studimit të rastit mundëson shqyrtimin e thelluar të një rasti ose të një ngjarjeje të veçantë, përmes së cilit, nxënësit përdorin rastet e jetës reale për të parë zbatimin në praktikë të njohurive teorike. Kjo metodë është e përshtatshme edhe për të mësuarit e edukimit për median dhe informimin, pasi nxënësit ndeshen përditë me forma të ndryshme të mesazheve nga media dhe nga ofrues të tjerë të informacionit. Ajo mundëson këndvështrimin sistematik të ngjarjeve, të mbledhjes së të dhëanave, të analizës së informacionit dhe të raportimit të rezultateve, gjë që për rrjedhojë, mbështet të mësuarit përmes kërkimit tek nxënësit. Nxënësit janë në gjëndje të kuptojnë në mënyrën më thellë dhe më të plotë lidhjen shkak-pasojë të ngjarjeve. Studimi i rastit mundëson lindjen dhe testimin e hipotezave.

Për shembull, nxënësit mund të ndërmarrin një studim rasti të strategjisë së organizimit të një fushate marketingu dhe të bëjnë një film të suksesshëm, një libër ose një produkt të rëndësishëm mediatik

5. Të mësuarit në bashkëpunim

Të mësuarit në bashkëpunim nënkupton atë qasje mësimore që i vendos nxënësit së bashku për të punuar për arritjen e disa objektivave të përbashkët. Të mësuarit në bashkëpunim përfshin nga punë në çift e deri në punë më të ndërlikuara të tilla si të mësuarit përmes projektit, të pyeturit e drejtuar mes bashkëmoshatarëve dhe të mësuarit e ndërsjellë. Të gjitha këto synojnë të sigurojnë zhvillimin e të kuptuarit konceptual dhe të menduarit e nivelit të lartë si dhe aftësi më të mira ndërpersonale e qëndrim më pozitiv ndaj shkollës dhe vetes dhe eksplorimin e mënyrës së menaxhimit të larmisë akademike në klasë. Kjo është një metodë e përshtatshme për të mësuarit dhe mësimdhënien e edukimit për median dhe informimin, sepse kërkon shkëmbimin e ideve dhe të mësuarit nga njëri tjetri. Një shembull i të mësuarit në bashkëpunimi është të punuarit në grup në një prej platformave të komunikimit online.

6. Analiza e teksteve

Nxënësit mësojnë të kryejnë analizën e teksteve përmes identifikimit të kodeve dhe karakteristikave gjuhësore dhe strukturore të gjinive të ndryshme të medieeve. Kjo analizë duhet të synojnë në të kuptuarit e mëtejshëm të koncepteve kryesore. Për rrjedhojë, nxënësIt mësojnë të identifikojnë mënyrën e përdorimit të kodeve dhe karakteristikave gjuhësore dhe strukturore për të krijuar tipa të ndryshëm të paraqitjes që u drejtohen grupeve të ndryshme të njerëzve. Nxënësit aftësohen të identifikojnë kodet “teknike”, “simbolike” dhe “të shkrimit” në çdo tekst mediatik. Nëse është e mundur, kjo analizë duhet të bëhet për kontekste të rëndësishme dhe jo thjesht si qëllim në vetvete. Për shembull, nxënësve mund t’u kërkohet të përzgjedhin një pjesë nga një tekst mediatik që është në interesin e tyre. Ky mund të jetë një artikull gazete, një video në Youtube ose pjesë e një video nga një burim i ri online. Nxënësit, në grupe dhe nën drejtimin e mësuesit analizojnë grupin e njerëzve që u drejtohet teksti, qëllimin, autoritn, karakteristikat teknike dhe ato të tekstit si dhe kontekstin.

7. Analiza e kontekstit

Nxënësve u tregohet si të kryejnë analizën e një teksti bazaë, veçanërisht në lidhje me konceptet kryesore të institucioneve dhe të teknologjive, por edhe në lidhje me qasjeve të ndryshme teorike. Në kuadër të kësaj analize, mësuesit ndihmojnë nxënësit të mësojnë për tema të tilla si sistemet e klasifikimit për filmin, televizionin dhe lojërat, si pronësia dhe përqëndrimi mbi median lidhet me çështjen e demokracisë dhe të fjalës së lirë.

8. Përkthimet

Kjo qasje pedagogjike mund të realizohet dhe të përdoret në forma të ndryshme në mjedise të ndryshme mediatike. Nxënësit mund të lexojnë një artikull të shkruar për një ngjarje në shkollë dhe e shndërrojnë atë një një histori të re për radion. Po kështu, ata mund të shohin një pjesë të shkurtër filmmi për fëmijë dhe të punojnë me grupe të vogla për të ndërtuar një histori që lidhet me skenën, duke identifikuar pamjet, këndet dhe pasazhet e përdorura.

Më tej, nxënësit mund të përdorin një përrallë dhe ta kthejnë në një skenarë për t’u filmuar. Ose ata mund të mbledhin materiale të ndryshme pamore që lidhen me jetën e dikujt dhe e përdorinkëtë si pikënisje për të ndërtuar një dokumentar të shkurtër për këtë person.

9. Simulimet

Simulimet përdoren shpesh si strategji për një prodhimin e një filmi ose të një njësie kurrikulare për median. Trajnerët e përdorin simulimin për t’u treguar studentëve për të mësuarit për median.

Në kuadrin e veprimtarisë, ata marrin rolin e një mësuesi në klasë, ndërkohë që të trajnuarit luajnë rolin e nxënësve.

Për shembull, studentët marrin rolet e një ekipi që prodhon një film dokumentar për një program televiziv për të rinjtë ose të gazetarëve që intervistojnë një mësues të edukimit për median për një program audio ose marrin rolin e një ekipi marketingu që përgatit një video përruese për studentët e ardhshëm në lidhje me jetën në universitet.

10. Prodhimi

Kjo metodë nënkupton të mësuarit duke bërë, si një aspekt i rëndësishëm i fitimit të njohurive në shekullin e njëzetënjë. Nxënësit duhet të nxiten të eksplorojnë të mësuarit në mënyrë më të thelluar e më të qëllimshme. Prodhimi i pëmbajtjes së medias dhe informimit u ofron nxënësve mundësinë të përfshihen në të mësuarit përmes eksplorimit dhe të bërit. Përmes krijimit të teksteve mediatike (audio, video ose në forma të tjera), nxënësit do të jenë në gjendje të eksplorojnë procesin e krijimit dhe të shprehin idetë, zërin dhe këndvështrimet e tyre. Për shembull, nxënësit mund të përdorin një program si Moviemaker, iMovie ose një tjetër të ngjashëm për të prodhuar një histori digjitale një minutëshe për një çështje që është në interesin e tyre.